



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUIJE

Nr. 1724 Prot.

Datë 27.03/2020

VENDIM

Nr. 58, datë 27.03/2020

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR (PDyV) PËR ZONËN E RE TË ZHVILLIMIT 1,
NJËSIA ADMINISTRATIVE KRUJË, BASHKIA KRUJË**

Në vijim të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 13.02.2020 "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Krujë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese"; gjithashtu në mbështetje të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për percaktimin e rregullave dhe te procedures se persheptuar per hartimin dhe miratimin e planit te detyruar vendor, si dhe procedures se miratimit te lejeve", kapitulli II, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 10.01.2020 "Për caktimin e Njësive Zbatuese për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e viti 2020",

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës nr. 1705 datë 01.04.2020, nr. 445 date 25.03.2020 nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) për miratimin e Planit të Detyruar Vendor (PDyV) për zonën e re të zhvillimit 1, Njësia Administrative Krujë, Bashkia Krujë, e shoqëruar nga Raporti i Vlerësimit Teknik të PDyV-së dhe dokumentacionin e plotë të PDyV-së.
2. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor (PDyV-së) për Zonën e re të zhvillimit 1, Njësia Administrative Krujë, Bashkia Krujë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

ARTUR BUSHI